



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

PJESËMARRJA E GJYKATËS KUSHTETUESE TË SHQIPËRISË

NË VEPRIMTARITË E CECC-IT PREJ ANËTARËSIMIT TË SAJ.



2005

KONGRESI I XIII, NIKOZIA, QIPRO 15 - 19 maj 2005

Tema "Kriteret e kufizimit të të drejtave të njeriut në praktikën e Gjykatës Kushtetuese".



2008

KONGRESI I XIV, VILNIUS, LITUANI 02 - 07 qershor 2008

Tema: "Probleme të ometimit ligjor në jurisprudencën kushtetuese".



2011

KONGRESI I XV, BUKURESHT, RUMANI 22 - 24 maj 2011

Tema: "Marrëdhëniet e Gjykatës Kushtetuese me Parlamentin dhe Qeverinë".



2014

KONGRESI I XVI, VJENË, AUSTRI 12 - 14 maj 2014

Temë: "Bashkëpunimi i Gjykatave Kushtetuese në Europë - Situa aktuale dhe perspektiva".



2017

KONGRESI I XVII, BATUMI, GJEOGJI 29 - 30 qershor 2017

Tema: "Roli i gjykatave kushtetuese në përcaktimin dhe zbatimin e parimeve kushtetuese".



2021

KONGRESI I XVIII, PRAGË, REPUBLIKA ÇEKE 24 - 25 shkurt 2021

Tema: "Katalogët e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar - zbatimin i katalogëve të të drejtave të njeriut në nivel ndërkombëtar dhe suprakombëtar".



2024

KONGRESI I XIX, KISHINAU, MOLDAVI 21-24 Maj 2024

Tema: "Format dhe kufizimet e vetëpërbajtjes gjyqësore: përvoja e gjykatave kushtetuese".

ANËTARËT E CECC

GJYKATAT ANËTARE

Data e anëtarësimit

Vendi i Konferencës

Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë	1972	Dubrovnik
Gjykata Kushtetuese Federale e Austrisë	1972	Dubrovnik
Gjykata Kushtetuese e Italisë	1972	Dubrovnik
Tribunali Federal i Zvicrës	1978	Vjenë
Tribunali Kushtetues i Spanjës	1981	Lozanë
Gjykata Kushtetuese e Portugalisë	1984	Madrid
Këshilli Kushtetues i Francës	1987	Lisbonë
Gjykata Kushtetuese e Turqisë	1987	Lisbonë
Gjykata Kushtetuese e Belgjikës	1990	Ankara
Tribunali Kushtetues i Polonisë	1990	Ankara
Gjykata Kushtetuese e Hungarisë	1992	Paris
Gjykata Supreme e Qipros	1994	Budapest
Gjykata Kushtetuese e Kroacisë	1994	Budapest
Gjykata Kushtetuese e Rumanisë	1994	Budapest
Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë	1994	Budapest
Tribunali Kushtetues i Andorrës	1996	Budapest
Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë	1997	Varshavë
Gjykata Shtetërore e Lihtenshtejnit	1997	Varshavë
Gjykata Kushtetuese e Lituaniës	1997	Varshavë
Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut	1997	Varshavë
Gjykata Kushtetuese e Maltës	1997	Varshavë
Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë	1997	Varshavë
Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke	1997	Varshavë
Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë	2000	Bruksel
Gjykata Kushtetuese e Armenisë	2000	Bruksel
Gjykata Kushtetuese e Azerbajxhanit	2000	Bruksel
Gjykata Kushtetuese e Bosnjë Hercegovinës	2000	Bruksel
Gjykata Kushtetuese e Gjeorgjisë	2000	Bruksel
Gjykata Kushtetuese e Letonisë	2000	Bruksel
Gjykata Kushtetuese e Luksemburgut	2000	Bruksel
Gjykata Kushtetuese e Republikës së Moldavisë	2000	Bruksel
Gjykata Kushtetuese e Ukrainës	2000	Bruksel
Gjykata Supreme e Estonisë	2003	Nikozi
Gjykata Supreme e Irlandës	2003	Nikozi
Gjykata Supreme e Norvegjisë	2003	Nikozi
Gjykata Supreme e Danimarkës	2006	Vilnius
Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi	2006	Vilnius
Gjykata Kushtetuese e Serbisë	2006	Vilnius
Gjykata Supreme e Monakos	2008	Vilnius
Gjykata Supreme e Holandës	2014	Vjenë
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	2025	Tiranë

KRYESIMI NGA GJYKATA KUSHTETUESE E SHQIPËRISË 2024 - 2027

CECC

2024/27

KONFERENCA E GJYKATAVE KUSHTETUESE EVROPIANE (CECC)





1972

VITI I THEMELIMIT TË CECC

Konferenca e Gjykatave Kushtetuese Evropiane (Conference of European Constitutional Courts - CECC) - bashkon gjykatat kushtetuese dhe institucione të tjera të ngjashme që ushtrojnë juridiksion kushtetues në Evropë.

41 ANËTARË

Qëllimi

- Promovimi i shkëmbimit të informacionit mbi metodat e punës dhe jurisprudencën kushtetuese të gjykatave anëtare
- Promovimi i pavarësisë së gjykatave kushtetuese si një element thelbësor në garantimin dhe respektimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, veçanërisht sa i takon mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

XIX Kongrese të zhvilluara – Kongresi i XX në Shqipëri

Organet e Konferencës janë:

Rrethi i Kryetarëve - organi qendror vendimmarrës i përbërë nga Kryetarët e Gjykatave dhe institucioneve anëtare me të drejta të plota;

Kongresi - zhvillohet çdo 3 vjet.

Në të marrin pjesë:

- anëtarët me të drejta të plota
- anëtarët e asociuar,
- vëzhgues si gjykatat evropiane suprakombëtare,
- komisionet dhe institucionet e Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian që merren me çështje të juridiksionit kushtetues
- të ftuar të tjerë.

Vizitoni faqen e përhershme informuese www.cecc-general.org



2000

VITI I ANËTARËSIMIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË SHQIPËRISË

Që prej anëtarësimit të saj, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme dhe ka luajtur një rol aktiv në veprimtaritë e organizuara në kuadër të Konferencës, përfshirë kongreset, si dhe takimet e Rrethit të Kryetarëve të gjykatave anëtare, duke kontribuar në shkëmbimin e përvojave dhe në zhvillimin e mëtejshëm të drejtësisë kushtetuese në hapësirën evropiane.



2024

VITI I PËRZGJEDHJES SË GJYKATËS KUSHTETUESE TË SHQIPËRISË NË KRYE TË CECC

Një moment historik

Në Kongresin zhvilluar në Kishinau, Moldavi, në vitin 2024, gjykatat anëtare votuan dhe zgjodhën Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë si gjykatën kryesuese të CECC për periudhën 2024-2027, si dhe organizatore të Kongresit të XX-të, i cili do të mbahet në Shqipëri.



2024
2027

KRYESIMI NGA GJYKATA KUSHTETUESE E SHQIPËRISË I CECC

Përmes kësaj zgjedhjeje:

- u vlerësua se Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ndan vlera e parime të përbashkëta me institucionet homologe evropiane në fushën e drejtësisë kushtetuese
- u shpreh besimi se Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë do të mbetet e përkushtuar për të:
 - forcuar bashkëpunimin ndërmjet gjykatave kushtetuese evropiane;
 - promovuar shkëmbimin e praktikave më të mira;
 - kontribuar në avancimin e standardeve të drejtësisë kushtetuese, në shërbim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore, si dhe të forcimit të shtetit të së drejtës.

Vizitoni faqen që Gjykata Kushtetuese i ka dedikuar Kryesimit dhe Kongresit të XX



Shkurt
2025

TAKIMI PËRGATITOR I RRETHIT TË KRYETARËVE TË CECC NË SHQIPËRI

u miratuan çështje organizative të Kongresit të ardhshëm XX-të të CECC, në Shqipëri në vitin 2027

u përcaktua tema e Kongresit;

u votua dhe u pranua nga shumica e gjykatave kushtetuese si anëtare me të drejta të plota Gjykata Kushtetuese e Kosovës - një moment historik pas një përpjekjeje 14-vjeçare për të qenë pjesë integrale e rrjetit evropian të gjykatave kushtetuese.

Tema e Kongresit të XX - "Liria e shprehjes – lajmet e rreme (fake news) si kërcënim për demokracinë".



Tetor
2027

Organizimi i Kongresit të XX të CECC në Shqipëri

Kongresi do të shërbejë si një platformë e rëndësishme për:

forcimin e rolit të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë në zhvillimin e drejtësisë kushtetuese në rajon, Evropë edhe në botë.

nxitjen e një dialogu të thelluar ndërmjet gjykatave kushtetuese mbi sfidat që lidhen me mbrojtjen e lirisë së shprehjes në epokën digjitale

promovimin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, duke forcuar vizibilitetin dhe besueshmërinë e saj institucionale;

kontribuimin në mënyrë të drejtpërdrejtë në përpjekjet dhe aspiratën e vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

